

L I G J

Nr.8146, datë 11.9.1996

PER MIRATIMIN ME NJE SHTESE TE DEKRETIT NR.1420, DATE
20.3.1996 "PER NENSHKRIMIN E AKTEVE NDERKOMBETARE"

Në mbështetje të neneve 16 e 28 pika 19 të ligjit nr.7491,
datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese",

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKES SE SHQIPERISE

V E N D O S I

Neni 1

Miratimin me një shtesë të dekretit nr.1420, datë 20.3.1996
"Për nënshkrimin e akteve ndërkombëtare, me përmbajtjen e plotë
si vijon:

"- Neni 1:

Nënshkrimi i traktateve, marrëveshjeve, protokolleve dhe
akteve të tjera ndërkombëtare, në të cilat subjekte janë shteti
shqiptar, Qeveria e Republikës së Shqipërisë, ministritë,
institucionet qendrore, si dhe organet e pushtetit lokal, mund
të bëhet vetëm pasi të jetë marrë pëlqimi i Ministrisë së Punëve
të Jashtme.

- Neni 2: Çdo dispozitë që bie në kundërshtim me këtë ligj
shfuqizohet.

- Neni 3: Ky dekret hyn në fuqi menjëherë."

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.1606, datë 17.9.1996 të Presidentit të
Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha